



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202400976/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2024

**Lënda:** Rekomandime për inspektimin e kryer në ambientet e shoqërimit në Komisaratin e Policisë Has.

**Drejtuar:** Z. Artan BAJRAKTARI  
Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë

**KUKËS**

Z. Dritan MUSAJ  
Shefi i Komisarariatit të Policisë

**HAS**

*Të nderuar,*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga inspektimi i kryer në ambientet e privimit të lirisë së personit në Komisaratin e Policisë Has më datë 8.07.2024.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Komisaratin e Policisë Has.

Inspektimi u krye sipas Planit Vjetor Inspektimi të MKPT-së të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit të inspektimit ishin znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Nertila Qafzezi, me detyrë Nd/Komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit"<sup>1</sup>, i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të

<sup>1</sup> Inspektimi në Komisaratin e Policisë Has është kryer në datën 05.07.2024, ligji i ri për Policinë e Shtetit nr.82/2024 "Për Policinë e Shtetit", ka hyrë në fuqi në datë 20.08.2024.

Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11.2023 për miratimin e procedurës standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”* dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar, ka detyrimin ligjor t’ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, që do të gjeni më poshtë:

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës u takua me Shefin e Krimeve të Komisarariatit Has z. Bislim Rustemaj, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim të takimit, z. Rustemaj informoi grupin e inspektimit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit referuar inspektimit të mëparshëm, lidhur me përmirësimin e kushteve të ambienteve të shoqërimit të këtij Komisaritati sipas procedurave standarde dhe për rritjen e performancës së punonjësve të policisë për respektimin e të drejtave ligjore të shtetasve të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar.

Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm vijoi takimin me punonjësit e policisë që shërbenin në zyrën e informacionit dhe në dhomat e shoqërimit. Theksojmë se, punonjësit e policisë u treguan bashkëpunues dhe transparentë gjatë komunikimit dhe inspektimit, që zhvilloi grupi inspektues në ambientet e këtij Komisaritati.

Në vijim inspektoi ambientet e shoqërimit, zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ ndaluar.

Nga informacioni i punonjësve të Komisarariatit, si dhe nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm<sup>2</sup>, rezultoi se:

---

<sup>2</sup> Rekomandimi i dërguar me nr. K4/1100-2 prot., datë 19.12.2023.

- Ishte zbatuar rekomandimi, për marrjen e masave të menjëhershme për dhënien e kartës së të drejtave në momentin në të cilin palët hyjnë në komisariat.
- Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi, për krijimin e dhomës për mbajtjen e provave materiale dhe largimin nga zyrat e punës së oficerëve të policisë gjyqësore të sendeve të cilat mund të ekspozojnë dhunë psikologjike/fizike tek personat me të cilët ata kryejnë veprime procedurale, pasi këto materiale mbaheshin në magazinën e institucionit.

Ndërkohë, nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme:

- Nuk ishte plotësuar rekomandimi, për gjetjen e fondeve për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisaratin e Policisë Has, sipas kritereve të parashikuara në Kreun VI, pika 4 të procedurës standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit duke përfshirë në të, ndërtimin e ambienteve të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur në konflikt me ligjin.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për marrjen e masave të menjëhershme, për krijimin e një ambienti të përshtatshëm për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë në këtë institucion, si dhe të ndërpritet praktika e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës të punonjësve të policisë të Komisarariatit.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për marrjen e masave të menjëhershme, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në korridorin e institucionit, si dhe në ambientin e dhomës së shoqërimit në Komisaratin e Policisë Has.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për marrjen e masave të nevojshme, për ndërtimin e tualeteve të ndara për femra dhe për meshkuj, si dhe pajisjen e tyre me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim, brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Has.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për marrjen e masave të menjëhershme, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomat e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.

Është rasti të theksojmë se lidhur me plotësimin e standardeve të ambienteve të shoqërimit dhe respektimin e të drejtave të të shoqëruarve, të ndaluarve/arrestuarve, rekomandimet e Avokatit të Popullit duhen vlerësuar maksimalisht nga institucionet që ato ju drejtohen dhe në mënyrë proaktive duhet të ketë një angazhim nga strukturat drejtuese të institucionit.

Avokati i Popullit është i ndërgjegjshëm se këto rekomandime kërkojnë ndërhyrje infrastrukturore dhe buxhetore që nuk varën nga njësia vendore, por çdo Komisariat duhet të demonstrojë se ka qenë konsekuent në kërkimin e fondeve, çka rezulton se nuk është kryer nga ana e administratës së komisariatit.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues konstatoi se, megjithëse në Komisaratin e Policisë Has ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe më konkretisht:

### **Ambienti i shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Në Komisaratin e Policisë Has ambientet e shoqërimit **nuk** ishin të ndërtuara sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022, ku parashikohet se dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për gratë, meshkujt madhorë dhe të miturit<sup>3</sup>.

Sipas informacionit të grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, **rezultoi se gjendja konkrete e ambienteve të shoqërimit ishte e ngjashme si në inspektimin pararendës**, ballafaquar me standardet e parashikuara në aktet normative dhe dokumentet ndërkombëtare, për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar brenda këtyre ambienteve.

Grupi i punës, pasi mori informacionin e nevojshëm, inspektoi nga afër ambientin e shoqërimit. Ky ambient ndodhej në katin e parë të ndërtesës së këtij Komisariati. Në hyrje të godinës ndodhej zyra e punonjësit të policisë së informacionit dhe ngjitur me të, ndodheshin 2 (dy) dhoma shoqërimi, të ndara më vete, një për persona të rritur dhe një dhomë e cila përdorej për shoqërimin e grave dhe të miturve.

---

<sup>3</sup> Kreu VI, pika 4, gërma “c” e procedurës standarde të punës “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022.

Mungesa e dhomave të shoqërimit për të miturit<sup>4</sup> në konflikt me ligjin është një problem thelbësor që paraqitet në këtë Komisarariat, duke mos siguruar garantimin e lirive, të drejtave dhe standardeve që kanë të bëjnë me shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin në mjediset e policisë, si dhe nevojave fizike dhe psikologjike, kur merren vendime që prekin ndonjë aspekt të ndalimit të tyre.

Dhomat e shoqërimit ishin me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve, të pajisura me stola për të mundësuar qëndrimin ulur të personave, por mungonte tavolina për të qenë një ambient sa më kreativ. Përmasat e dhomave të shoqërimit ishin 4x4m me kapacitet për mbajtjen dhe qëndrimin ulur deri 4 persona.

Dhomat e shoqërimit kishin dritare të cilat lejonin ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Ndërkohë dyert e dhomave të shoqërimit ishin prej druri, të cilat kishin mundësi për t'u mbyllur nga jashtë. Megjithatë sjellim në vëmendje se: *“Në pjesën e sipërme të dyerve duhet të krijohet një hapësirë me përmasa 60 x 40 cm, në të cilën montohet një xham transparent dhe i armuar (i pa çmontueshëm dhe rezistent/i pathyeshëm ndaj goditjeve me grushte, shkelma, kokë). Hapësira e dritares/sportelit të derës nga ana e korridorit të dhomave sigurohet me një rrjetë teli me shufra me seksion/trashësi 0,6 mm të cilat vendosen në mënyrë vertikale dhe horizontale duke krijuar kuadrate 5 x 5 cm.”*<sup>5</sup> Për këtë arsye edhe dyert nuk përmbushnin kërkesat e procedurës standarde të punës *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022.

Dhomat e shoqërimit ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare dhe të lyera. Në fund të korridorit të ambienteve të shoqërimit ndodhej një tualet, i cili ishte i pastër dhe kishte çezmë me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje. Në ambientet e këtij Komisaritati mungonte tualeti për gra, duke mos garantuar standardin e Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022 procedura standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, ku parashikohet se: *“Brenda ambienteve të shoqërimit ose ngjitur me to, duhet të ketë tualete, të ndara më vete për femra dhe meshkuj, të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim”*<sup>6</sup>.

---

<sup>4</sup> Kreu VI, pika 4 e procedurës standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, ku parashikohet se: *“Dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për persona madhorë, mitur dhe femra, të cilat kanë sipërfaqe nga 16-20m<sup>2</sup>, secila”*.

<sup>5</sup> Kreu VI, pika 4, gërma “e.6.4” e procedurës standarde të punës *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022.

<sup>6</sup> Kreu VI, pika 4 gërma “e.2” *“Pranë dhomave të shoqërimit dhe ngjitur me to ndërtohen dhe funksionojnë tualetet për kryerje të nevojave personale të ndara për femra dhe meshkuj, me sipërfaqe të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve përkatëse dhe funksionimin për qëllimin që kanë, me sipërfaqe 6 – 8 m<sup>2</sup>”*.

Në Komisarariat e Policisë Has kishte gjenerator funksional për furnizimin me energji në rast defektesh. Ambientet e shoqërimit nuk kishin sistem ngrohjeje/ftohjeje.

Në këtë Komisariat, **ende nuk ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të ambienteve të këtij institucioni**, një konstatim i cili është i përsëritur edhe nga inspektimi i mëparshëm. Në kushtet e vendndodhjes së Komisarariatit, si dhe për të garantuar sigurinë e personave të shoqëruar, është i domosdoshëm instalimi i sistemit të kamerave në ambientet e brendshme dhe të jashtme të tij.

Mbikëqyrja me kamera e të gjitha mjediseve të Komisarariatit, përveç atyre mjediseve ku çenohet privatësia, është vlerësuar nga ana e institucionit tonë, si një proces thelbësor për tre arsye:

**Së pari**, mbikëqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, **si nga ana e të shoqëruarve, të ndaluarve apo të arrestuarve**, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

**Së dyti**, mbikëqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të komisarariatit, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

**Së treti**, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të shoqëruarve, të ndaluarve apo të arrestuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet përkatëse që hartojnë institucionet monitoruese të pavarura.

Në Komisarariat e Policisë Has, gjatë periudhës 01.01.2024 deri më 8.07.2024 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **15** persona, të gjithë ishin shtetas madhorë sipas përcaktimeve të bëra në nenin 109 dhe 112/1 të ligjit nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar. Nga këqyrja e regjistrin të shoqërimit mesatarja e qëndrimit në komisarariat e personave të shoqëruar ishte deri në 5 orë. Në momentin e inspektimit, nuk kishte asnjë shtetas të shoqëruar në dhomat e shoqërimit.

Gjatë inspektimit u këqyrën dhe zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore në të gjitha ambientet e Komisarariatit. Nga monitorimi që iu bë zyrate të oficerëve të policisë gjyqësore, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë komisariat kishte një dhomë magazinë për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale. Kjo dhomë shërbente për ruajtjen e provave materiale të fiksuara përgjatë procedimeve penale e

aksesueshme për oficerët në 24/7. Këto prova materiale ishin të fiksuara dhe të ruajtura me procesverbalet përkatëse dhe të paketuara.

Nga verifikimi i regjistrit të marrjes dhe dorëzimit të personave të shoqëruar, si dhe kopjeve të procesverbalit të veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar, në rubrikën me shënimet në lidhje me ankesat/kërkesat e të shoqëruarve rezultoi se, për vitin 2024 nuk kishte asnjë ankesë lidhur me ushtrim dhune apo trajtim degradues nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit.

### **Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre.**

Në Komisariatit e Policisë Has nuk kishte ambiente të sigurisë. Personat e arrestuar/ndaluar pasi evidentoheshin në regjistrin përkatës, dërgoheshin menjëherë në dhomat e sigurisë të Komisariatit të Policisë Kukës.

### **Regjistri për evidentimin e personave të shoqëruar, si dhe trajtimi i të shoqëruarve, gjatë veprimeve që kryen policia**

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisariatit e Policisë Has, “Regjistri i evidentimit të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurat standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë” miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se: Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta.<sup>7</sup> Me miratimin e ligjit të ri nr.82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, ka hyrë në fuqi ulja e kohës së ndalimit të përkohshëm, e cila në asnjë rast nuk tejkalon 5 orëshin dhe fillon që në momentin kur punonjësi ndalon personin dhe zgjat deri në sqarimin e çështjes.

Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar me saktësi nga punonjësit e policisë të këtij institucioni. Punonjësit e policisë sqaruan se si orar shoqërimi fillestar vendosej momenti i arrestimit/ndalimit në vendin e privimit të lirisë, në çdo rast ky orar shërben dhe në momentin e hyrjes së personave në Komisariatit e Policisë Has dhe ky orar shërben edhe në procedurat që ndiqen lidhur me arrestimin e personave kur ekzistojnë kushtet që urdhërohet arrestimi i tyre. Avokati i Popullit sqaron se ora e shoqërimit

---

<sup>7</sup> Kreu VII, Procedurat standarde: “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

është ajo e vendosjes së personit në mbikëqyrjen policore dhe jo ajo e futjes brenda ndërtesës së Komisarariatit. Për këtë arsye duhen marrë masat përkatëse.

Gjithashtu, në zyrën e informacionit kishte karta me të drejtat e personave të shoqëruar, ku informoheshin nga policia për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke iu siguruar informacion të qartë verbal dhe shkresor në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë. Avokati i Popullit nëpërmjet **Mekanizmit Kombëtar kërkon dhënien e kopjes së kartës** së të drejtave që në momentin e hyrjes në Komisarariat, për të garantuar njohuritë e të shoqëruarve për të drejtat e tyre.

Në këtë Komisarariat administrohej regjistër për të miturit të shoqëruar në konflikt me ligjin, ku evidentohen të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente dhe ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se nuk kishte asnjë të shoqëruar të mitur.

Nga inspektimi, u konstatua se në këtë Komisarariat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar, për periudhën që kryhej inspektimi, ishin evidentuar tre kërkesa për shoqërim në spital të cilat ishin zbatuar sipas shënimeve në regjistër. Lidhur me plotësimin e këtij regjistri, Avokati i Popullit e cilëson si një proces të rëndësishëm lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut.

Gjithashtu përcaktohet qartë në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*” se zbatimi i të drejtave të njeriut dhe siguria për personin e shoqëruar, në të gjitha rastet e shoqërimeve, punonjësit e policisë janë të detyruar të njohin dhe zbatojnë të drejtat e personave të shoqëruar, si dhe japin siguri për jetën, shëndetin, kushtet e qëndrimit dhe trajtimin human në këto ambiente. Konkretisht, sipas parashikimeve në Kreun VI, pika 1, gërma “1”, personat e shoqëruar kanë të drejtën “*Të paraqesë kërkesa apo ankesa për mënyrën e shoqërimit, mbajtjes, trajtimin dhe respektimin të të drejtave nga personeli policor gjatë shoqërimit dhe mbajtjes në ambientet e policisë*”.

### **Ambientet e intervistimit**

Në Komisariatin e Policisë Has nuk ka një dhomë më vete të monitoruar me sistemin e kamerave, që të shërbejë për intervistimin/ marrjen në pyetje të personave të shoqëruar nga punonjësit e policisë. Në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023 është evidentuar qartë nevoja



e krijimit të dhomave të intervistimit<sup>8</sup>: Në fakt, një strukturë e tillë mund të sigurojë një regjistrim të plotë dhe autentik të procesit të intervistimit, duke lehtësuar në masë të madhe hetimin e çdo pretendimi për keqtrajtim. Ky fakt është në interes si të personave që janë keqtrajtuar nga policia, ashtu edhe të punonjësve të policisë që janë përballur me pretendime të pabaza se janë përfshirë në keqtrajtime fizike apo presione psikologjike.

Në parim, regjistrimi audio-vizual duhet të mbulojë të gjitha fazat e marrjes në pyetje nga policia, duke përfshirë dhënien e informacionit për të drejtat në fillim të intervistës. Kjo do të sigurojë që marrja në pyetje nga ana e policisë të kryhet në përputhje me ligjin dhe do të ndihmojë në parandalimin e çdo praktike të nënshtrimit të personave të ndaluar në marrje në pyetje joformale përpara marrjes në pyetje zyrtare. KPT inkurajon autoritetet shqiptare të zgjerojnë aplikimin e regjistrimit audio-vizual të intervistave të policisë për marrjen në pyetje të të gjithë personave të ndaluar.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e intervistimit të personave të shoqëruar në një ambient më vete, që të jetë i monitoruar nëpërmjet sistemit të kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre.

Gjithashtu, edhe intervistimi apo marrja në pyetje e të miturve në konflikt me ligjin që shoqërohen, kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë dhe jo në ambiente të veçanta, sikurse është e parashikuar në dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe procedurën standarde<sup>9</sup>. Mekanizmi Kombëtar e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se, intervistat me të miturit duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm dhe të pajisur me orënditë e nevojshme si tavolina dhe karrige, në një mjedis sa më të qetë, pa shtrëngime fizike dhe presione psikologjike. Në kushtet aktuale që ndodhen zyrat e punës të punonjësve të policisë, intervistimi i tyre mund të shkaktojë traumatizim plotësues të të miturit.<sup>10</sup>

---

<sup>8</sup> electronic recording of police interviews, fq.13, <https://rm.coe.int/1680ae233b>.

<sup>9</sup> Kreu VII. Pika 2.1/k e procedurës standarde thuhet se: “I mituri në konflikt me ligjin gëzon të drejtat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale si dhe të drejtat e posaçme të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur”. I mituri duhet të mbahet në dhoma/ambiente të ndarë nga personat madhorë dhe të ndarë nga të miturit e tjerë sipas gjinisë”.

<sup>10</sup> Mekanizmi Kombëtar e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave, pasi nga intervistimi i tyre në zyrat e punës të specialistëve të policisë, mund të shkaktohet traumatizim plotësues i fëmijëve.

## **Ndihma juridike dhe psikologjike**

Grupi i inspektimit konstatoi se në momentin e inspektimit, në dhomat e shoqërimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar. Në mungesë të tyre, u intervistuan punonjësit e policisë që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar, ku rezultoi se, në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej asistencë ligjore apo mbrojtja me avokat kryesisht.

Përgjatë inspektimit në Komisarlatin e Policisë Has, u konstatua se kishte një listë të afishuar në ambientet e shoqërimit ku mund të evidentoheshin avokatët kryesisht.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut.

Nga biseda me oficerët e policisë gjyqësore konstatuam se prania e psikologut sigurohej nga Urdhri i Psikologut. Me shkresën nr. 4 prot, datë 08.01.2024 të gjitha komisarlatet në varësi të Drejtorive Vendore të Policisë janë informuar në lidhje me përditësimin e listës së psikologëve asistues për të miturit gjatë procesit të intervistimit nga ana e oficerit të policisë, si dhe psikologët e certifikuar si ekspertë asistues dhe vlerësues. Në këtë komisarlat kishte një psikolog i cili ju përgjigjej kërkesave të këtij komisarlati.

Në rastet kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, ata i shoqërojnë në Qendrën Shëndetësore Has, për të marrë ndihmën mjekësore.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisarlat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në Nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3 të procedurave standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse<sup>11</sup>.

Në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit. Rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “*Formulari i raportit të shoqërimit ose ndalimit/arrestimit*”.

---

<sup>11</sup> Ligji nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*” i ndryshuar.

Gjatë inspektimit u evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme, ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë, mbaheshin procesverbalet përkatëse, një kopje e të cilit firmosej dhe i jepej personit të shoqëruar.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”.

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave nga DVP Kukës për gjetjen e fondeve për ndërtimin e dhomave të shoqërimin në Komisarriatin e Policisë Has, sipas kriterëve të parashikuara në Kreun VI, pika 4 të procedurës standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit duke përfshirë në të, ndërtimin e ambienteve të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur në konflikt me ligjin. Kjo masë të zbatohet brenda vitit 2025.
2. Marrjen e masave nga DVP Kukës për krijimin e një ambienti të përshtatshëm për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë në këtë institucion, si dhe të ndërpritet praktika e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës të punonjësve të policisë të Komisarriatit<sup>12</sup>. Kjo masë të zbatohet brenda vitit 2025.
3. Marrjen e masave të nevojshme nga Komisarriati Has për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në korridorin e institucionit, si dhe në ambientin e dhomës së shoqërimin në Komisarriatin e Policisë Has. Kjo masë të zbatohet brenda vitit 2024.
4. Marrjen e masave të nevojshme nga DVP Kukës për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët. Kjo masë të zbatohet brenda vitit 2025.

---

<sup>12</sup> Kreu VI, pika 4/i e procedurës standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”.

5. Marrjen e masave të nevojshme nga DVP Kukës për ndërtimin e tualeteve të ndara për femra dhe për meshkuj, si dhe pajisjen e tyre me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim, brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Has. Kjo masë të zbatohet brenda vitit 2025.
6. Marrjen e masave nga Komisaritati Has për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomat e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit. Kjo masë të zbatohet brenda vitit 2024.
7. Marrjen e masave nga Komisaritati Has për vënien në parametra të dyerve të dhomave të shoqërimit sipas parashikimeve të procedurës standarde të punës “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022. Kjo masë të zbatohet brenda vitit 2024.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI  
i Mekanizmit Kombëtar  
për Parandalimin e Torturës  
(MKPT)**

**Ahmet PRENÇI**

Konc.:  
G.Çarkaxhiu